



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Punëve të Jashtme-  
Ministarstvi Inostranih Poslova  
Ministry of Foreign Affairs

## MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

### NDËRMJET

### AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### DHE

### KLINIKËS LIGJORE NDËRKOMBËTARE TË UNIVERSITETIT TË IOWA-së, KOLEGJIT TË DREJTËSISË<sup>1</sup>

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MM") është rezultat i diskutimeve ndërmjet Klinikës Ligjore Ndërkombëtare të Universitetit të Iowa-së, Kolegjit të Drejtësisë ("Klinika") dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës ("Ministria") në fillim të muajit tetor të vitit 2013, dhe duke u përmbyllur kështu me takime ndërmjet Nathan Miller, Drejtorit të Klinikës ("Drejtori") dhe stafit të ministrisë, në maj të vitit 2014, në Prishtinë.

Ky MM përcakton objektivat dhe përgjegjësitë e Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës ("Akademisë") dhe Klinikës, lidhur me punën që do të realizohet nga Klinika, në emër të Akademisë. Ky MM nuk ka për qëllim të jetë një kontratë obligative, por në vend të kësaj një shprehje të pritjeve të përbashkëta të palëve.

#### A. Palët

1. Akademia harton studime strategjike mbi politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

---

<sup>1</sup> KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

("Kosova"), trajnon stafin diplomatik, ofron mundësi arsimore për qytetarët e Kosovës, dhe organizon konferenca, forume dhe seminare. Z. Skender Durmishi është Drejtor i Akademisë.

2. Klinika është pjesë e Universitetit të Iowa-së, Kolegjit të Drejtësisë. Studentët shpërblehen me kredi akademike për ofrimin e asistencës ligjore për qeverinë dhe OJQ-të mbi çështjet e ndërlidhura me të drejtën publike ndërkombëtare, të drejtat ndërkombëtare të njeriut, zhvillimin dhe sundimin e ligjit. Studentët punojnë nën mbikëqyrje të Drejtorit, i cili ka punuar apo punon në më shumë se 20 shtete.

## **B. Objektivat e Punës së Klinikës ndaj Akademisë**

Objektivat e punës së Klinikës do të jenë:

1. Mbështetja e përpjekjeve të vazhdueshme për sigurimin e anëtarësimin të plotë të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ("OKB");
2. Asistimi në hartimin e një liste prioritare të regjimeve të traktatit, përfshirë kërkesat për anëtarësim dhe obligimet pas anëtarësimin.
3. Mbështetja për përpjekjet për të siguruar përcaktimin e Kosovës si një entitet i veçantë nga ana e Divizionit për Statistika të Kombeve të Bashkuara (UNSD) dhe Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim ("ISO"); dhe
4. Mbështetja e përpjekjeve për t'i siguruar Kosovës një nivel të lartë të domenit (p.sh., "ks" apo "kv") nga Korporata e Internetit për Caktimin e Emrave dhe Numrave (ICANN).

Në mbështetje të këtyre objektivave, UICLP-ja do të hartoj:

1. Një analizë të detajuar, për qarkullim të brendshëm, të rrugës ligjore dhe pengesave për anëtarësim të plotë në OKB;
2. Një draft dokument të pozicionit, për qarkullim të jashtëm, mbi çështjen juridike për anëtarësimin e plotë të Kosovës në OKB;
3. Një memorandum i historikut mbi politikën, procedurat dhe vendimet e mëparshme të UNSD, IOS dhe ICANN; si dhe,

4. Një plan i propozuar për evokim, me disa opsione për UNSD, IOS, dhe, ICANN. Klinika, për aq sa është e mundur dhe me miratim të Akademisë, do të përgatitet që të realizoj planin e përzgjedhur nga Akademia.

### **C. Afatet kohore dhe zotimi i Palëve**

Në mënyrë që të arrihen objektivat, Palët bien dakord që afati i përgjithshëm kohor i përshkruar më poshtë, duhet të zbatohet dhe t'i nënshtrohet ndryshimeve të arsyeshme. Plani i mëposhtëm i punës është i përkohshëm, dhe mund të modifikohet me pajtim të Klinikës dhe Akademisë.

1. Analiza e Detajuar dhe Dokumenti i Qëndrimit lidhur me anëtarësimin në OKB
  - a. Duke filluar nga data 26 gusht 2014, Klinika do të fillojë të hulumtoj çështjet e listuara. Klinika do të ofrojë një përshkrim të propozuar në Akademi deri me 1 tetor 2014.
  - b. Klinika do të paraqesë një draft të analizës së detajuar dhe dokumentit të qëndrimit tek Akademia për komente deri me 21 nëntor 2014.
  - c. Pas pranimit të komenteve dhe sugjerimeve nga Akademia, Klinika do të rishikojë dhe të paraqesë versionet përfundimtare deri më 10 dhjetor 2014
  - d. Pas pranimit dhe aprovimit të produktit final të punës së Klinikës, Akademia do të aranzhojë një prezantim të Klinikës për stafin e Akademisë në Uashington DC dhe/ose Kosovë.
2. Memorandum në lidhje me Regjimet e Traktatit
  - a. Gjatë hulumtimit dhe hartimit të analizave lidhur me anëtarësimin në OKB, Klinika do të konsultohet me Akademinë për të kuptuar më mirë prioritetet e Ministrisë për traktatet e lidhura.
  - b. Duke filluar nga janari i vitit 2015, Klinika do të fillojë me punën e saj në bazë të prioritetëve të dakorduar.
  - c. Afati i fundit për dorëzimin përfundimtar mbetet të përcaktohet në bazë të numrit të regjimeve të traktatit të përzgjedhura, por gjithsesi nuk do të jetë më vonë se 1 maj 2015.
3. Dokumenti i Historikut dhe Plani i Avokimit
  - a. Pas takimeve në Prishtinë, në të cilën këto projekte janë identifikuar si një prioritet i lartë për Kosovën, Klinika tashmë ka filluar hulumtimin

- b. Me 15 korrik 2014, Klinika do të paraqesë një skicë tek Akademia.
- c. Me 30 shtator të vitit 2014, Klinika do të dorëzojë letrën sfond dhe planet e propozuara të avokimit për diskutim të mëtejshëm me Akademinë.
- d. Klinika, deri në masën e mundur dhe me miratimin e Akademisë, do të përgatitet të zbatoj planin e përzgjedhur nga Akademia.

#### D. Përgjegjësitë e Klinikës dhe Akademisë

- a. **Konfidencialiteti:** Klinika do të ruajë konfidencialitetin e klientit dhe do të respektoj me etikën e përfaqësimit ligjor dhe standardet profesionale të përgjegjësisë. Përderisa Klinika mund të publikojë faktin për partneritetin e saj me Akademinë në kushte të përgjithshme (p.sh., "ofrimin e ndihmës juridike mbi çështjet me prioritet të lartë për Akademinë Diplomatike të Republikës së Kosovës") **nuk** do të shpalos natyrën e saktë të punës së tij, përveç nëse kërkohet për të ruajtur llogaridhënien e tij ndaj administratës së Universitetit. Nën asnjë rrethanë, Klinika nuk do të shpalos komunikimet e klientit apo produktin e punës, pa lejen e Akademisë. Klinika do të komunikojë me Akademinë në lidhje me përditësimin e statusit, zhvillimet e rëndësishme, dhe çdo ndryshim në afate kohore.
- b. **Komunikimi:** Akademia do të caktojë një person kontaktues për Klinikën, të cilët do të marrin përsipër: të jenë të gatshëm për konferenca përmes telefonit dhe Skype, t'iu përgjigjen pyetjeve dhe kërkesave për dokumente, dhe të lehtësojnë komunikimin me anëtarët tjerë të stafit të Akademisë dhe Ministrisë.
- c. **Shpenzimet:** Klinika ofron shërbimet e saj pa pagesë, por ajo ka resurse të kufizuara financiare dhe nuk mund të zotohet të mbuloj ndonjë kosto përtej shpenzimeve normale të bëra në një përfaqësim. Shpenzimet e tilla normale përfshijnë, për shembull, thirrjet ndërkombëtare telefonike, tarifat e bazës së të dhënave ligjore, si dhe shpenzimet e zyrës. Akademia dakordohet të mbuloj shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për Klinikën, për vizita në Uashington DC dhe/apo Prishtinë për prezantimin e rezultateve të punës së saj. Çdo shpenzim shtesë duhet të diskutohet nga palët para se të bëhen ato shpenzime.

#### E. Ndryshimet

- a. Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij

Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve, nëpërmjet konsultimeve.

- b. Dispozitat e këtij memorandumi mund të ndryshohen me pëlqimin reciprok me shkrim të Palëve.

**F. Hyrja në fuqi**

- a. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet valide, përveç nëse njëra Palë njofton me shkrim Palën tjetrën për synimin e saj për të shfuqizuar këtë memorandum, të paktën tre muaj paraprakisht.

E DAKORDUAR NGA DHE MES:

Akademia Diplomatike e Kosovës

Nga: \_\_\_\_\_ (nënshkrimi) 02.09.2014 (data)

Z. Skender Durmishi, Drejtor

**Klinika Ligjore Ndërkombëtare, Kolegji i Drejtësisë, Universiteti i Iowa-së**

Nga: \_\_\_\_\_ (nënshkrimi) 27.8.2014 (data)

Z. Nathan Miller, Drejtor